



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E**  
**TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1749/10 prot.

Tiranë, më 11.10.2024

**VENDIM**

**Nr. 16, datë 11.10.2024**

**PËR KONTROLLUESIN**

**“FONDI BESA” SH.A**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Fondi Besa” (në vijim “Kontrolluesi”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 134, datë 19.08.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave K.GJ., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS K81911023C dhe ushtron aktivitetin si institucion mikrofinanciar, i cili ofron të gjithë format e kredidhënies, duke përfshirë kredinë konsumatore e hipotekore.

Në datën 19.07.2024, pranë Zyrës së Komisionerit është administruar nëpërmjet postës elektronike ankesa e z. K.Gj., përmes së cilës pretendohet se, përfaqësues të institucionit financiar jobankar “*Fondi Besa*” sh.a, Dega Astir, vazhdimisht kanë kontaktuar familjarët e ankuesit ( prindin ) nëpërmjet telefonatave duke i informuar për vonesën e datës së shlyerjes së kështit të kredisë dhe duke shkaktuar shqetësime në familje.

Në kuadër të zgjidhjes së ankesës, Zyra e Komisionerit, përmes shkresës nr. 1749/3 prot., datë 05.08.2024 ka kërkuar informacion nga Kontrolluesi mbi trajtimin e ankesës, si dhe duke bërë me dije se, dhënia e këtij informacioni është një detyrim ligjor, në zbatim të nenit 32 të Ligjit.

Kontrolluesi ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 28824 prot., datë 01.08.2024, administruar me tonën nr. 1749/3 prot., datë 05.08.2024, ku ndër të tjera ka bërë me dije se: *“Klienti K.GJ. është paraqitur pranë degës së Fondit Besa sh.a “Tirana 8” për një aplikim në shumën 600,000 lekë së bashku me nënën e tij znj. M.GJ., e cila do të ishte garant në kredi. Në momentin e aprovimit të kredisë është vendosur që garant në kredi të mos jetë e ëma por një person tjetër, pasi znj. M.GJ., rezultonte të kishte një kredi aktive pranë Fondit Besa në shumën 650,000 lekë. Pavarësisht se nuk u vendos garant në kredinë e të birit znj. M.GJ., në mënyrë informale ka kërkuar të informohet për ecurinë e kësaj kredie dhe z. K.GJ., ka qenë prezent në këtë kërkesë”.*

Gjithashtu, në shkresën e sipërcituar drejtuar Zyrës së Komisionerit, Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion Formularin e Aplikimit për kredi dhe *“Klauzolën e Pëlqimit Paraprak”* të znj. M.Gj.

Nga dokumentet e mësipërme evidentohet se, nënshkrimi i *“Klauzolës së pëlqimit paraprak”*, nga znj. M.GJ., në cilësinë e kredimarrësit, kryhet vetëm me qëllim deklarimin se i gjithë informacioni i dhënë prej kredimarrësit është i saktë dhe i plotë, si dhe për të autorizuar Kontrolluesin për qëllime të vlerësimit të aplikimit lidhur me vlerësimin e rrezikut të kredisë dhe besueshmërisë së personit.

Sa më sipër, duke qënë se nga dokumentet e vendosura në dispozicion prej Kontrolluesit, nuk arrihet të provohet nëse subjekti i të dhënave (ankuesi) ka dhënë pëlqimin për përdorimin/shpërndarjen e të dhënave personale në palët të treta (në rastin konkret tek e ëma), Zyra e Komisionerit me Urdhrin nr. 134, datë 19.08.2024 ka kryer hetim administrativ pranë Kontrolluesit me objekt, verifikimin e ankesës dhe zbatimin e Ligjit. Në datën 04.09.2024, grupi i hetimit administrativ u paraqit në ambientet e Kontrolluesit për të vijuar me kontrollin sipas objektit të urdhrin të hetimit.

2. Gjatë hetimit administrativ, konstatohet se, subjekti i të dhënave K.Gj. është palë në cilësinë e kredimarrësit, në kontratën e kredisë datë 15.04.2024, midis tij dhe Kontrolluesit. Dorëzanës në këtë kontratë konstatohet personi E.E.

Gjithashtu, M.Gj., prind i ankuesit, rezulton të jetë palë në cilësinë e kredimarrësit, në kontratën e kredisë datë 28.03.2024, midis saj dhe Kontrolluesit. Dorëzanës në këtë kontratë konstatohet personi L.Gj.

Kontrolluesi për secilin subjekt kredimarrës disponon dosjen përkatëse të përbërë nga dokumentacioni si më poshtë :

- ID;
- Certifikatë familjare;
- Vendim personal;
- Propozim Huaje;
- Kërkesë Nr. 2;
- Vërtetime të ardhurash;
- Dokumenta Kolaterali;
- Deklarat pengu & borxhi;
- Dokumeta për të ardhurat;
- Klauzola e pëlqimit paraprak;
- Raport BOA;
- Skica e vendbanimit;
- Formulari i monitorimit;
- Kontratë Kredie

Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale të ankuesit K.Gj., grupi i hetimit administrativ ka konstatuar se aktet juridike, në të cilat Kontrolluesi merr pëlqimin nga subjektet e të dhënave personale lidhur me objektin e veprimtarisë së tij, janë përkatësisht “Klauzola e pëlqimit paraprak” dhe kontrata e kredisë midis palëve, konkretisht neni 11 “Pëlqimi i Kredimarrësit për përpunimin e të dhënave personale”.

Nga analizimi i kontratës së kredisë midis Kontrolluesit dhe ankuesit K.Gj., konstatohet se në Nenin 11 parashikohet :

*“Pëlqimi i Kredimarrësit për përpunimin e të dhënave personale”*

- *11.1 Kredimarrësi/Dorëzuesi autorizon Kredidhënësin për të kryer, nëse është e nevojshme, përpunimin, administrimin, transmetimin, transferimin ndërkombëtar dhe zbulimin e të dhënave personale dhe sensitive të Klientit "të dhëna", që vihen në dispozicion të Kredidhënësit, sipas kuptimit të dhënë në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar). Kredimarrësi/Dorëzuesi pranon dhe autorizon Kredidhënësin që të dhënat e tij të dërgohen në institucionet qeveritare dhe/ose autoriteteve në përputhje me rregullat e detyrueshme ligjore.*

- *11.2 Ky autorizim jepet nga Kredimarrësi/Dorëzuesi në kushtet e respektimit të detyrimeve ligjore për trajtimin e të dhënave personale nga Kredidhënësi, si dhe duke marrë në konsideratë se Kredidhënësi dhe kontrolluesit e tjerë të autorizuar prej tij ose me ligj pranë të cilëve mund të transferohen këto të dhëna kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin e sigurt të të dhënave.*
- *11.3 Kredimarrësi/Dorëzuesi autorizon Kredidhënësin për të kryer dërgimin e mesazheve elektronike të iniciuara nga Kredidhënësi drejt adresave të e-mail-it, numrave të celularëve dhe çdo mjeti tjetër të komunikimit, këto adresa të deklaruara nga Kredimarrësi/Dorëzuesi me vullnetin e lirë të tij, me qëllim për t'i mbajtur ata të informuar për ecurinë e marrëdhënieve me Kredidhënësin."*

Gjithashtu, në nenin 15 të kësaj kontrate, parashikohet se, të gjitha njoftimet apo komunikimet midis palëve në këtë kontratë, do të konsiderohen të kryera vetëm nëse janë të dërguara në adresat e Kredimarrësit dhe Dorëzuesit.

Për sa më sipër, rezulton se, Kontrolluesi aplikon marrjen e pëlqimit, për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, të cilët janë në cilësinë e kredimarrësit dhe dorëzuesit në kontratën e kredisë dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore që lindin nga ky detyrim kontraktor.

3. Lidhur me objektin e ankesës, nga analizimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, konstatohet se në rastin konkret nuk është dhënë pëlqimi i subjektit të të dhënave për shpërndarjen e tyre në palë të treta (prindit të ankuesit), pasi referuar kontratës së lidhur ndërmjet subjektit të të dhënave në cilësinë e kredimarrësit dhe Kontrolluesit në cilësinë e kredidhënësit, rezulton se ky i fundit është i autorizuar për përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave personale të ankuesit, sipas përcaktimeve të nenit 11 dhe nenit 15 të kontratës së kredisë konsumatore.
4. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka aplikuar marrjen e pëlqimit nga subjekti i të dhënave personale K.Gj, lidhur me shpërndarjen/zbulimin e të dhënave personale ndaj palëve të treta, në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit. Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancë dëgjimore, ku shprehu qëndrimin e tij lidhur me konstatimet e grupit të hetimit.

Gjatë zhvillimit të seancës Kontrolluesi parashtrori verbalisht të njëjtat argumente të paraqitura edhe me shkrim me shkresën nr. 29300 prot., datë 30.09.2024, administruar me tonën nr. 1749/8 prot., datë 30.09.2024.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është përgjegjësi e Kontrolluesit marrja e masave për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germës “a”, të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) *kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze pasi ato lidhen me garantimin e parimeve dhe kriterëve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 30, 31, 39 pika 1, germa “a”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### **V E N D O S A:**

- 1 Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2 Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;

Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:

- i. vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikën 2 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

- 3 Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

- 4 Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
- 5 Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 11.10.2024.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**